

## Vendim nr. 21 datë 05.02.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 05.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (L) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** LEKË ARAPI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 42, datë 06.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 53, datë 19.02.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-701, datë 25.04.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 14.02.2017 kërkuesi Lekë Arapi ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi një mjet i rëndë pune i ka prishur gardhin rrethues, si dhe ka kryer gërmime në pronën e tij. Këto veprime janë kryer nga disa shtetas të cilët kanë pretenduar se arsyeja e punimeve ishte hapja e një rruge në zbatim të një vendimi të Këshillit Bashkiak.

2. Mbi bazën e kallëzimit të kërkuesit, prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 283 të vitit 2017, pa autor, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Shkatërrimi i pronës” të parashikuara nga nenet 248 dhe 150 të Kodit Penal (KP). Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ka vlerësuar se projekti për rikonstruksionin e rrugës nuk cenonte pronën private të kërkuesit, pasi ai ishte zbatuar në pronë shtetërore, ndaj bazuar në nenet 328, paragrafi 1, shkronja “b” dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale, ai i ka paraqitur Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë kërkesën për pushimin e procedimit penal për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 42, datë 06.12.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se personat përgjegjës për kryerjen e punimeve kishin vepruar në zbatim të urdhrave të dhëna nga eprorët, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore” dhe se pretendimet e kërkuesit për dëmtimin e pronës nuk bazoheshin në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur apel kërkuesi.

4. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 53, datë 19.02.2018, me të njëjtin arsyetim. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-701, datë 25.04.2023 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së dhe, se pretendimet që lidhen me vlerësimin e fakteve dhe provave nuk i përkasin juridiksionit të kësaj gjykate.

6. Në datën 30.11.2023 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit, e cila pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000 me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 14.12.2023.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë pasqyruar faktin se kallëzimi i kërkuesit drejtohej jo vetëm kundrejt personave që kryen punimet, por edhe ndaj anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe kryetarit të Bashkisë Mirditë, të cilët në dijeni të plotë dhe në kundërshtim me ligjin kishin marrë një vendim të kundërligjshëm. Po kështu, kallëzimi u drejtohet edhe personave që kishin falsifikuar dokumentet e akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe personave që kishin ndryshuar zërat kadastralë të pronës në mënyrë arbitrare. Pavarësisht se kërkuesi kishte paraqitur prova, prokuroria nuk ka kryer hetim të plotë dhe efektiv për këtë fakt.

7.1.2. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi pavarësisht përpjekjeve të kërkuesit për të siguruar një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe paraqitjes së tij në sportelet e saj, kjo e fundit i është përgjigjur se vendimi nuk ishte zbardhur ende. Vetëm në përfundim të afatit ligjor 4-mujor, Gjykata e Lartë e ka informuar për të tërhequr vendimin, duke shënuar me shënim dore datën 22.09.2023 në kopjen e vendimit.

7.2. *Të drejtën e pronës*, pasi vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Mirditë i ka dëmtuar pronën e trashëguar, të cilën e ka disponuar qetësisht dhe pa ndërprerje që prej vitit 1991. Vendimi është ankimuar në rrugë gjyqësore nga prefekti i qarkut dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 558, datë 29.07.2021, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij. Vendimi gjyqësor tashmë ka marrë formë të prerë.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat

dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi me pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës ka vënë në lëvizje organin e prokurorisë me kallëzim penal, për pushimin e të cilit u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë provon interesin e tij në çështjen e parashtruar.

10. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve penale të cilat kanë vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale të kallëzuar prej tij. Në këtë situatë, ai e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se ka qenë vetë kërkuesi, i përfaqësuar me avokat, i cili ka paraqitur rekursin për të vënë në lëvizje procesin në Gjykatën e Lartë, që do të thotë se ka pasur interes për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2023-701, datë 25.04.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë,

kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.11.2023, pra pas 7 muajve e 5 ditëve. Në përmbajtje të ankimit kushtetues kërkuesi ka pretenduar se pavarësisht përpjekjeve të tij për të siguruar një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe paraqitjes në sportelet e saj, kjo e fundit i është përgjigjur se vendimi nuk është zbardhur ende. Sipas tij, vetëm në përfundim të afatit ligjor 4-mujor, Gjykata e Lartë e ka informuar për të tërhequr vendimin, duke shënuar me shkrim dore datën 22.09.2023 në kopjen e tij. Mirëpo, Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 1568/1 prot., datë 10.10.2023, ka informuar Kolegjin se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit në datën 27.04.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin si vendim.

13. Për sa më lart, dhe duke u bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuesi prezumohet të ketë marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë ditën e publikimit të vendimit, më 27.04.2023. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual nuk konstatohet ndonjë rrethanë faktike për marrjen dijeni të vendimit në një datë të mëvonshme. Vetëm paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin “*u paraqit në sportel në datën 22.09.2023*”, nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht të kërkuetit për të, pasi një shënim i tillë mund të vendoset nga sekretaria gjyqësore në çdo rast kur një palë ndërgjyqëse paraqitet për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor. Ndaj, në këtë aspekt, pretendimi i tij nuk mund të rrëzojë prezumimin për datën e marrjes dijeni të vendimit. Prandaj, Kolegji çmon se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuetit, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, duhet konsideruar data 27.04.2023 kur vendimi është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe është bërë i disponueshëm për kërkuetin. Duke iu referuar kësaj date, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.